



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1847 prot.

Tiranë, më 28.06.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 3175/1, DATË 10.01.2024 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASIT Z. VLADIMIR SPAHIU DHE XHON SPAHIU"

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Xhon Spahiu me nr. 653 prot., datë 23.03.2022, në të cilën ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve D.G. me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, E.GJ. dhe L.C. dhe ish magjistratit P.Z., me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe J.M. me detyrë Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3175/1 prot., datë 10.01.2024 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit z. Vladimir Spahiu dhe z. Xhon Spahiu", bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "c", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Megenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas adresës së lënë nga ankuesi Vladimir Spahiu: Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Berat;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

